



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.02.2019
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të Komisionit për Integrimin European për periudhën 11 shkurt – 01 mars 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”.
4. Komunikim: Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka dërguar raportimin për vitin 2018 mbi ecurinë e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European.
5. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, , Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Musa Ulqini dhe Sadri Abazi, Eglantina Gjermani .

Mungojnë:

Genc Pollo, Fatmir Velaj Aldo Bumçi, Vangjel Dule, Grida Shqina, Jorida Tabaku, dhe Viktor Tushaj.

Të ftuar:

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve, hapim mbledhjen e Komisionit të Integritetit European të datës 12 Shkurt 2018. Të ftohen mediat të jenë të pranishëm.

Sot në rendin e ditës kemi:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.02.2019
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të Komisionit për Integritetin European për periudhën 11 shkurt – 01 mars 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”.
4. Komunikim: Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka dërguar raportimin për vitin 2018 mbi ecurinë e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin European.

5. Çështje të tjera.

Vijojme me miratimin e procesverbalit të datës 04.02.2019 i cili është dërguar paraprakisht nga Sekretariati i Komisionit në adresat tuaja elektronike.

Kush është dakort? Miratohet.

Përpara jush është edhe kalendar i punimeve të Komisionit për Integritetin European për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019.

Kush është dakort? Miratohet.

Para se të kalojmë në shqyrtimin e projektligjit në rendin e ditës më lejoni t’Ju komunikoj se qeveria nëpërmjet Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme ka dërguar raportimin për vitin 2018 mbi ecurinë e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin European na zbatim të ligjit 15/2015.

Kush ka ndonjë koment në lidhje me raportimin e Ministrisë për vijimin e procedurave për shqyrtim të këtij raporti? Po, Z. Balla, fjala për Ju

Taulant Balla – Zonja drejtuese e mbledhjes do të ishte e mirë që në këtë mbledhje të ishte e pranishme edhe opozita për të diskutuar vendosjen e seancave dëgjimore për këtë.

Megenëse opozita nuk është prezente dhe ne nuk e dimë se cili është qëndrimi i saj, nuk mund të vonojmë që raporti të prezantohet në seancë plenare dhe të zhvillohet debati përkatës

për të në seancë plenare. Sigurisht, ky vendim i takon Konferencës së Kryetarëve, ndaj mendoj t'i kërkojmë kësaj të fundit që të fillojmë planifikimin e seancës plenare për diskutimin e raportit dhe punën për hartimin e projektrezolutës.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Balla!

Nëse ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët në lidhje me këtë çështje, për sa kohë po diskutojmë edhe kalendarin, mund të shprehet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke qenë se secili prej jush ka marrë tashmë nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme një kopje të raportit të dërguar për vitin 2018 lidhur me ecurinë e procesit të integritetit europian, me propozimin e zotit Balla dhe në mungesë të opozitës, ia kalojmë seancës plenare për shqyrtim.

Pa humbur kohë, vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit të radhës “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Të pranishëm nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kemi zëvendësministrin, Ilir Halilaj, dhe përgjegjësen e Sektorit, zonjën Julinda Bare.

Ju lutem, zoti Halilaj, na bëni një prezantim të shkurtër të projektligjit.

Fjala është për ju.

Ilir Halilaj – Përshëndetje!

Të nderuar anëtarë të komisionit, po ju prezantoj projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Dy nga objektivat kryesorë të këtij projektligji kanë të bëjnë me garantimin e një konkurrence të drejtë për fermerët, me prodhuesit e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Karakteristikë e veçantë, që u shtohet këtyre produkteve, gjithashtu, është edhe garantimi i informacionit të nevojshëm për konsumatorin në lidhje me cilësinë e produkteve bujqësore që dalin në treg.

Pikërisht, në këtë projektligj përcaktohen detyrat dhe kompetencat e organeve për emërtimin “specialitet tradicional i garantuar”, që parashikon vënien në funksion të komisionit të skemës së cilësisë së këtyre produkteve, gjithashtu edhe dhënien e detyrave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për garantimin, verifikimin dhe certifikimin e këtyre produkteve në momentin që ato prodhohen dhe dalin në treg. Pra, kemi dy struktura, që i përgjigjen zbatimit të këtij projektligji.

Duhet thënë se ky është një projektligj i përafuar me rregulloren nr. 1151/2012 të Bashkimit Europian, rreth 34 nene të këtij projektligji janë përafuar dhe është një nga kushtet që ne duhet të plotësojmë si Ministri e Bujqësisë për garantimin e cilësisë dhe për mbrojtjen e produkteve tradicionale që dalin në treg.

Senida Mesi – Ju faleminderit!

A ka diskutime apo pyetje?

Arben Kamami – Mirëdita!

Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të miratimit të “Axfhendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm” nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar rezolutën për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të “Axfhendës 2030” të shteteve anëtare të OKB-së. Në rezolutën e Kuvendit parashikohet monitorimi i zbatimit të këtyre objektivave dhe për këtë është kërkuar nga Kryetari i Kuvendit që në relacionin e projektligjit për një periudhë transitorë, deri në miratimin e rregullores, ndryshimi i nenit 68, të përfshihet edhe një zë që duhet të paraqesë se cili nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm synohet të përmirësohet. Duke lexuar relacionin e projektligjeve, vihet re se një zë i tillë nuk rezulton të jetë i plotësuar.

Më lejoni t’ju pyes se cila është arsyeja që nuk është përfshirë “Axfhenda 2030”. Cilat janë objektivat që përmirësohen me anë të këtij projektligji? Në rast se ju nuk keni përgjigje në këtë moment, më lejoni t’ju kërkoj një përgjigje me shkrim në lidhje me pyetjet që parashtrova. Kuvendi i Shqipërisë e ka detyrim ligjor të monitorojë zbatimin e ligjeve, por duhet të ketë një pikënisje dhe, sikurse edhe ju jeni në dijeni, pikënisja për Kuvendin është ligji dhe arsyeja pse është hartuar ky ligj, pra relacioni.

Ju faleminderit!

Senida Mesi – Po, zoti Halilaj.

Ilir Halilaj – Faleminderit për pyetjen, zoti deputet!

Do t’i kthejmë një përgjigje me shkrim komisionit në lidhje me pyetjen tuaj, sepse nuk mund të japim dot një përgjigje tani.

Faleminderit!

Senida Mesi – Me lejoni të bëj një koment.

Kjo kërkesë, drejtuar qeverisë, është bërë në mënyrë të vazhdueshme nga të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe ndoshta do të ishte e udhës që edhe ne si komision të dilnim me një kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar Këshillit të Ministrave, ku në çdo relacion që ju dërgoni në lidhje me projektligjet apo projektvendimet e ndryshme të shtohet edhe një pikë, pikërisht “Axfhenda 2030 dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm”, pra ky komponent të jetë pjesë e

integrale në çdo relacion që vjen nga Këshilli i Ministrave. Nëse jeni dakord, mund të përpiloni një shkresë me shkrim, ku në çdo vendim që vjen nga Këshilli i Ministrave një çështje e tillë jo vetëm për rastin konkret, por për të gjitha rastet ku “Axxhenda 2030” dhe 17 objektivat duhet të jenë të përfshirë.

Para se të kalojmë në votim, dua t’ua jap fjalën të ftuarve nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit.

Po, zoti Kasneci!

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Projektligji për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore është përfaruar pjesërisht me Rregulloren e BE-së, të Parlamentit Europian dhe Këshillit Europian të datës 21 nëntor 2012, për skemat e cilësisë në produktet bujqësore dhe ushqimore.

Shërbimi ynë e ka analizuar këtë projektligj dhe tabelën e përputhshmërisë, madje kemi paraqitur katër sugjerime për një përafrim më korrekt. Për eficiencë të kohës suaj dhe punës në komision, ne e kemi diskutuar paraprakisht me përfaqësuesit e qeverisë, ku nga 4 sugjerime, në 2 kemi gjetur dakordësinë, 1 pranuar ta tërheqim, ndërsa 1 sugjerim tjetër ngelet për t’u diskutuar. Kjo mbetet në vlerësimin tonë, por gjithsesi do ta vendosë komisioni.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Kasneci!

Për çështjet që u diskutuan, u dakordësuam në bashkëpunim me ministrinë, me zotin Halilaj. Komisioni është dakord me ndryshimet e propozuara.

Kalojmë në votimin në parim.

Të gjithë janë dakord.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

A jeni dakord me ndryshimet e propozuara nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit?

Të gjithë janë dakord.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi, me ndryshimet e propozuara nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit.

Miratohet.

Mbledhja e ardhshme, ashtu siç kemi rënë dakord, është në datën 18 shkurt në orën 12:00, ku do të shqyrtojmë projektligjin “Për censusin e popullsisë dhe banesave”, propozim i Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA